

Dëfrim SALIU
Shejnaze Ajdini - MURTEZI
Avdi VISOKA
SKËNDERBEU NË LETËRSINË FRËNGE

UDC 821.133.1:929Skenderbeg

Abstrakt: Për Skënderbeun janë shkruar një numër i madh veprash të fushave të ndryshme. Libra mbi princin shqiptar filluan të shfaqen në Evropën Perëndimore në fillim të shekullit XVI. Një nga veprat më të hershme të historive mbi jetën dhe veprën e Skenderbeut, është Historia de Vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum Principis shkruar nga Marin Barleti dhe botuar katër dekada pas vdekjes së Skënderbeut. Në shekujt XVI dhe XVII libri i Barletit ishte përkthyer në frëngjisht nga Jacques de Lavardin. Skënderbeu në letërsinë frënge vazhdon të trajtohet edhe në poemën e Pierre de Ronsard (1576), poemën Les Tragiques të Agrippa d'Aubigne dhe në veprën Les Essais të Michel de Montaigne. Anekdotën për Skënderbeun, Montaigne e ka marrë nga libri i Dhimitër Frankut, i cili u përkthye në frëngjisht dhe u botua më 1544. Ideologu i madh i iluminizmit frëng, Voltaire-i në veprën e tij historiko-filozofike Sprovë për doket dhe shpirtin e kombeve (1756), thekson se “sikur perandorët grekë (bizantinë) të ishin si Skënderbeu, perandoria e Lindjes do të kishte qëndruar më këmbë”.

Fjalët kyçe: Skënderbeu, letërsi, frënge, Barleti.

Abstract: For Skanderbeg has written a large number of works in different fields. Books for the albanian prince began to appear in Western Europe in the early 16th century. One of the earliest stories of Skanderbeg's life and work is the History of Life and Gesture Skanderbeg, Epirotarum Principis written by Marin Barleti and published four decades after Skanderbeg's death. In the 16th and 17th centuries Barlet's book was translated into French by Jacques de Lavardin. Skanderbeg in French literature continues to be dealt in the poem of Pierre de Ronsard (1576), the poem Les Tragiques of Agrippa d'Aubigne and in Les Essais of Michel de Montaigne. The anecdote for Skanderbeg, Montaigne received from the book of Demetrius Frank, which was translated into French and published in 1544. The great ideologist of the French Enlightenment, Voltaire in his historical-philosophical work Essay on the Customs and the Spirit of the Nations (1756), states that: “if the Greek (Byzantine) emperors were like Skanderbeg, the East Empire would have stood on foot”.

Key words: Skanderbeg, literature, french, Barlet.

1. Botimet e shkrimeve të autorëve frënge mbi Skënderbeun

Faik Konica është i pari ndër rilindasit tanë që i hyri gjurmimit dhe popullarizimit të shkrimeve të autorëve të huaj mbi Skënderbeun.¹ Konica që i pari ndër shqiptarët që vërejti se eseisti i shquar frëng i shekullit XVI, Michel de Montaigne e kishte përmendur në veprën e tij Skënderbeun, me titullin *Caractère de Scanderbeg*, anekdotë nga eseu i parë i librit të parë të Montaigne-it.² Montaigne kishte lexuar jo vetëm monografinë e Dhimitër Frankut mbi Skënderbeun, nga e cila kishte nxjerrë anekdotën, por kishte lexuar edhe përkthimin frëngjisht të *Historisë së jetës dhe të veprave të Skënderbeut* të Marin Barletit, së cilës i referohet disa herë në esetë e veta.

Dy vjet më vonë Konica boton në revistën *Albania* edhe një sonet të poetit të shquar frëng të Pléiades, Pierre de Ronsard në të cilin këndohet për Skënderbeun. Ky sonet ishte shkruar me rastin e botimit të përkthimit të adaptuar në frëngjisht të *Historisë së jetës dhe të veprave të Skënderbeut* të Marin Barletit nga Jacques de Lavardin, më 1576.³

Në prag të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, më 1912 u botua përkthimi shqip nga frëngjishtja e një drame që kishte si kryepersonazh Skënderbeun⁴, shkruar nga një autor frëng e që ishte botuar në Paris, më 1891. Autori i kësaj drame, prift me profesion, veprën nuk e nënshkroi me emrin e vet, frati Rogasianus, por me anagramin Rogatien Faurrès. Për dramën e Rogasianusit mund të shtrohet pyetja: pse mu ajo u zgjodh për përkthim në gjuhën shqipe, i vetmi shpjegim që mund të jepet pse kjo dramë u zgjodh për përkthim është se kjo dramë u kishte rënë më lehtë në dorë patriotëve shqiptarë, prandaj edhe u përkthye dhe u botua në gjuhën shqipe.

Vepra e Marin Barletit është burimi kryesor i dokumentimit mbi Skënderbeun dhe epokën e tij gjatë shekujve, gjithashtu të panumërta janë veprat që u shkruan mbi heroin tonë në më shumë se 20 gjuhë. Veprat e ndryshme që i referohen Skënderbeut janë të shpërndara nëpër biblioteka të ndryshme të botës, shpesh ato janë edhe unike, ndërsa numri i madh i gjuhëve në të cilat janë botuar bën të pamundshme që jo vetëm lexuesi i rëndomtë, por edhe studiuesi i historisë dhe i figurës së heroit tonë kombëtar të ketë një pasqyrë të qartë mbi vendin e Skënderbeut në historinë dhe në letërsinë botërore pa monografitë përkatëse.⁵

Skënderbeu në veprat e autorëve frëngë zënë një vend të rëndësishëm, dhe ky fakt mund të shpjegohet nëse kemi parasysh rrezatimin e kësaj gjuhe gjatë shekujve. Në anën tjetër veprat e autorëve frëngë ushtruan ndikim edhe në disa letërsi të tjera të huaja dhe u përkthyen në gjuhë të tjera. Interesimi i francezëve për Skënderbeun daton mjaft herët, mirëpo kemi një interesim pasiv, sepse as në kohën e Skënderbeut as më vonë Franca nuk i dha ndonjë përkrahje popullit shqiptar në luftën e tij për çlirimin kombëtar.

Marin Barleti thekson në veprën e tij se në ushtrinë e Skënderbeut bënë pjesë gjithashtu më se pesëdhjetë galë.⁶ Njëri ndër sundimtarët më të fuqishëm të Europës në epokën e Skënderbeut, Filipi III, duka i Bourgogne-s i dërgoi ndihmë në të holla Skënderbeut pasi e detyroi sulltan Muratin të tërhiqej me turp nga rrethimi i Krujës. Ndërsa pas vdekjes së Skënderbeut, mbreti i Francës, Karli VIII më 1594 pasi pushtoi Napolin, mori iniciativë për të kaluar në Ballkan dhe të zbarkoj në Shqipëri, për të luftuar kundër Perandorisë Osmane, mirëpo kundërshtimet që i hasin në Itali e shtrënguan mbretin e Francës të hiqte dorë nga kjo ekspeditë.

¹Ymer Jaka, *Lidhjet letrare shqiptaro-frënge*, Rilindja, Prishtinë, 1979, fq. 67.

²Albania 6, 1897, f. 79.

³Jacques de Lavardin, *Historia e jetës dhe të veprave të Skënderbeut*, Paris, 1576.

⁴Rogatien Faurrès, *Skënderbeu ose heroi shqipëtar*, Sofje, 1912.

⁵Ymer Jaka, *Skënderbeu në letërsinë frënge*, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq. 10.

⁶Marin Barleti, *Historia e jetës dhe të veprave të Skënderbeut*, Prishtinë, 1967, fq. 234.

2. Skënderbeu në poezinë frënge

Tema e Skënderbeut në letërsinë frënge nis me disa poezi, Skënderbeu i frymëzoi së pari disa poetë, rrugën e të cilëve e ndoqën pastaj shumë romancierë, novelistë dhe autorë dramatikë. Pierre de Ronsard është i pari i cili i përkushtoi poezi Skënderbeut, është soneti mbi Skënderbeun, të cilin e shkroi me rastin e botimit të historisë së Skënderbeut nga Jacques de Lavardin në vitin 1576. Soneti është shkruar në vargje dymbëdhjetëroresh, Ronsard-i ishte adhures i zjarrit të kulturës antike, dhe e vë Skënderbeun në lidhje me heronjtë e mitologjisë dhe historisë antike si Akilin dhe Pirron.

Në këtë sonet Shqipëria identifikohet me Epirin, përmendet mbreti i Epirit, Pirron dhe e kaluara e Epirit, ndërsa Skënderbeu përmendet për herë të parë në vargun e shtatë. Duhet pasur parasysh që më 1544 ishte përkthyer dhe botuar në gjuhën frënge monografia e Dhimitër Frankut, pastaj me Jacques de Lavardin-in nis popullarizimi i Skënderbeut në Francë. Ronsard-i bënë një ndërlidhje midis Skënderbeut dhe Akilit dhe Pirros, për t'ia ngritur vlerën e këtij personaliteti.

Pastaj kujtohen 22 fitoret e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane dhe në një kohë kur kjo Perandori ende paraqiste rrezik për qytetërimin europian. Në sonetin e Ronsard-it Skënderbeu këndohet si trim që fuste lemerinë në radhët e ushtrisë së sulltanit dhe që vinte në rrezik muret e kështjellave të tyre. Soneti mbi Skënderbeun, nuk përmendet në asnjërin nga studimet e specialistëve të Ronsard-it, soneti për herë të parë është gjetur nga studimet e bërë në Francë të Faik Konicës, ai për herë të parë e përktheu në gjuhën shqipe dhe e botoi në revistën e tij të njohur *Albania*.¹

Në 500 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut Perlat Xhiku e përkthen këtë sonet në vargje të rimuara dhe me një koment për poezinë. Përveç Ronsard-it, sonet i kushton edhe Florent Chrétien që ishte bashkëkohës i Ronsard-it, por ky sonet nuk është aq i rëndësishëm për arsye se mendohet se është një kopjim i sonetit të Ronsard-it. Gjithashtu njëri ndër nxënësit dhe miqtë më besnikë të Ronsard-it, Amadis Jamyn i kushton një odë Skënderbeut, e cila përbëhet nga 12 strofa.²

Agrippa d'Aubigné botoi më 1616 poemën *Les Tragiques* që përbëhet nga 900 vargjedhe ndahet në shtatë libra. Në librin e shtatë të titulluar *Gjykimi* d'Aubigné këndon për trimërinë dhe fisnikërinë e Skënderbeut. Midis vargjeve 184 dhe 204 paraqitet historia e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane:

*„Kështu Skënderbeut iu rrëmbye fëmijëria
Nga mësues të atillë natyra e tij u nënshtrua
Në një saraj të poshtër, të mbushur plot kënaqësi
Ai thithi në vend të qumështit madhësitinë e Lindjes,
Nëpërmjet zërit të myftive ia mbushën veshët
Me veprat e Muhamedit dhe mrekuellitë e plakave.
Porse gjaku i mirë ngadhënjeu mbi mashtrimin e arsyes,
Dhe e bëri të përbuzë flamujt me gjysmëhëna
Dhe armët që tërë botën nënshtruan,
Ai kundër Perandorit të madh guxoi të luftojë
Me një ushtri të vogël, të pafuqishme,
U bë prijësi i atyre që nuk e njihnin fare.
Prej nga dolën aq luftëra, aq trimëri, aq lavdi
Që gjithkush mund t'i lexojë, e askush të mos i besojë”.*³

¹Faik Konica, *Një vjershë e Ronsard-it permi shqiptarët*, Revista Albania 1, 1900, fq. 44-46.

²Ymer Jaka, *Skënderbeu në letërsinë frënge*, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq. 30.

³Agrippa d'Aubigné, *Les Tragiques*, Paris, 1873, fq. 278-279.

3. Skënderbeu në romanin frëng

Romani frëng i shekullit XVII pati një hov të madh, ndonëse në kohën kur u shkrua panë dritën më shumë se 1200 romane, ku dalloheshin romanet heroike frënge. Romancieri i parë frëng i cili nxori lëndën për veprën e tij nga historia e Skënderbeut është Pierre de Boissat. Mirëpo, meqë romani i tij *Historia e Negrepontos* (Histoire Nègrepontique) u botua më 1631.¹

Kohë kur personalitetet e njohura historike ende nuk kishin hyrë solemnisht në romanin heroik, meqë vepra e Boissat-së hyn në radhën e atyre veprave që bëjnë një urë kaluese midis romanit të aventurave dhe romanit epik, ai zgjodhi si hero të romanit një stërnip të Skënderbeut, mirëpo historinë e këtij të fundit e ndërthuri në njërin ndër episodet e veprës. Sipas Georges Petrovich,² konsiderohet se autor i romanit *Historia e Negrepontos* është Jean Baudouin, disa mendojnë se Baudouin është pseudonim i Boissat-së.

Bashkëkohësi dhe miku i Boissat-së, Chorer pohon se Boissat-së e ka shkruar këtë roman duke u nxitur nga Jean Baudouin dhe pohon se veprën e ka shkruar brenda njëzet ditëve.³ Një pohim i këtillë, vështirë mund të vërtetohet, është fort pak i besueshëm. Skepticizmi ynë lidhur me këtë çështje mbështetet në faktin se romani ka gati 700 faqe dhe nga ana tjetër Boissat nuk qe ndonjë shkrimtar i frytshëm dhe me ndonjë përvojë letrare që të shkruante këtë vepër kaq shpejt.

Historia e Negrepontos është e vetmja vepër e këtij lloji të cilën ai e ka shkruar. Kompozicioni i romanit *Historia e Negrepontos* është shkruar sipas rregullave të romanit të epokës baroke, në përputhje me teknikën e romanit heroik, autori e fut lexuesin menjëherë në qendër të ngjarjeve, pra si epopeja nis *in medias res*.

Ngjarja qendrore e romanit, të cilën e rrëfen vetë autori, nis me ikjen e një anije me disa krishterë nga limani i Algjerit. Heroi i romanit, Aleksandri pasardhës i Skënderbeut, është njëri ndër ata që nuk arrijnë të kthehen në anije. Miqtë e tij kujtojnë se ai është vrarë ose është zënë rob nga berberët, mirëpo zhdukja e Aleksandrit e godit rëndë heroinën e romanit, Olimpën, e cila ishte bijë e familjes së njohur të Paleologëve.⁴ Ashtu si e duan rregullat e këtij romani, anija mbytet, por shpëtojnë vetëm personazhet të cilat i duhen autorit. Këto personazhe zbarkojnë në Ishujt Kanarie dhe atje gjejnë strehim.

Roman tjetër për Skënderbeun shkroi në vitin 1644 edhe Urbain Chevreau që e titulloi *Skënderbeu* (Scanderbeg),⁵ është roman që është botuar në dy vëllime dhe i tërë romani ndahet në shtatë libra. Në këtë roman Skënderbeu është protagonist kryesor i romanit, ndërsa për dallim nga *Historia e Negrepontos* si personazh i dytë këtu është heroina e romanit është Amazia (Amasie) një stërmbesë e Skënderbeut, apo si mbesa e Stanishës vllaut të Skënderbeut.

4. Alphonse de Lamartine dhe Skënderbeu

Alphonse de Lamartine ka shkruar për popujt me të cilët ka pasur kontakte në udhëtimet e tij, mbasi në veprat e tij ai bën fjalë edhe për shqiptarët, madje kishte edhe letërkëmbim me shkrimtarin arbëresh Jeronim De Rada, do të përpiqemi të hedhim pak dritë në shkrimet e Lamartinit për popullin shqiptar.

¹Ishulli i detit Egje, Eubea, i cili gjendet në lindje të Atikës, në kohët e lashta quhej Negrëponto. Meqë një pjesë e veprimit të romanit të Boissat-së zhvillohet në këtë ishull, autori e ka vënë emrin e tij në titullin e veprës

²Georges Petrovich, *Scanderbeg (Georges Castriota)*, Paris, 1881, fq. 121.

³Ymer Jaka, *Skënderbeu në letërsinë frënge*, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq. 61.

⁴Ymer Jaka, *Skënderbeu në letërsinë frënge*, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq. 62.

⁵Urbain Chevreau, *Scanderbeg*, Paris, 1644.

Në këtë mënyrë do ta lajmë edhe një borxh që kemi ndaj poetit mbasi, sa na është e njohur, deri tani nuk është studiuar vendi që zënë shqiptarët në veprën e Lamartine-it.¹ Gjatë udhëtimit të parë në Orient më 1832-1833 Lamartine-i kaloi nëpër Ballkan² dhe la dëshmi interesante për popujt e vendeve që vizitoi.³ Lamartine-i kaloi dy herë skaj Shqipërisë, mirëpo nuk pati rast ta njohë së afërmi popullin shqiptar, për të cilin ai edhe më parë kish shfaqur interesim. Në këtë pikëpamje popujt e tjerë të Ballkanit patën më shumë fat, mbasi dëshmia që ka lënë poeti në udhëpërshkrimin e tij për vendet nëpër të cilat kaloi ka një vlerë të madhe.

Megjithatë, edhe pse nuk i njohu për së afërmi shqiptarët (përpos një takimi që pati me Jeronim De Radën dhe me disa shqiptarë në Azinë e Vogël), në veprën e Lamartine-it bëhet mjaft fjalë për popullin tonë, sidomos për heroin tonë kombëtar, Skënderbeun. Pas botimit të përmbledhjes së poezive *Méditations poétiques* (Përsiatje poetike), Lamartine-i më 1825 shkroi poemën *Le dernier chant du pèlerinage de Chalde Harold* (Kënga e fundit e pelegrinazhit të Çajld Haroldit), e cila është një vazhdim i poemës së Bajronit, që pat vdekur një vit më parë në Greqi.

Duke bërë fjalë në këtë poemë për përkrahjen e madhe të poetit anglez revolucionit grek për çlirimin nga perandoria osmane, Lamartine-i vë në pah pjesëmarrjen e shqiptarëve në ushtrinë e formuar nga Bajroni për këtë qëllim. Me këtë rast në shënimet e poemës, ai e sheh të udhës të japë edhe disa shpjegime lidhur me atdheun e këtyre ushtarëve. Ndër të tjera në këto shënime lexojmë: „Shqipëria përfshin një pjesë të Maqedonisë, Ilirinë dhe Epirin. Ky vend, që mund të vërehet nga bregdeti i Italisë, është njëri ndër viset më të bukura të Greqisë.

Lordi Bajron thotë se nuk ka pendë as penel që t'i paraqesë bukuritë e viseve të saj, na mund të shtojmë se nuk ka pendë as penel që mund të shprehë sakrificën heroike të banorëve të saj në luftërat që kanë bërë kohëve të fundit, më shumë se askush tjetër, për çlirimin e Greqisë. Shqiptarët u ngjajnë, thonë, malësorëve të Skocisë, veshjet, pamja dhe doket e tyre janë të ngjashme”.⁴ Që nga viti 1825, pra Lamartine-i kishte një ide të përgjithësuar mbi shqiptarët dhe vendin e tyre. Është kjo ide mjaft abstrakte, e cila do të gjejë vend pas disa vjetësh në një vepër tjetër të këtij autori, në *Histoire de la Turquie* (Historia e Turqisë).

Ndonëse Lamartine-i është i njohur si njëri ndër poetët më të mëdhenj romantikë frëngë, veprimtaria e tij si historian e burrë shteti nuk mund të lihet pas dore kur bëhet fjalë për opusin e tij. Natyrisht, Lamartine-i historian ngel në hijen e Lamartine-it poet. Vetë titujt e veprave historike të Lamartine-it tregojnë se në to trajtohen probleme aktuale dhe asosh që u interesojnë lexuesve të kohës së tij. Kështu, edhe *Histoire de la Turquie*,⁵ e cila na intereson, u botua në kohën e luftës së Krimesë.

Kjo vepër, ndërkaq, ndryshon kryekëput nga ato të autorëve të tjerë frënge që janë botuar më parë. Derisa shumë historianë në Perandorinë Osmane e shohin një armike të Europës dhe një kërcënim permanent për botën krishtere, apo e trajtojnë historinë e kësaj perandorie, dikur shumë të fuqishme, në mënyrë objektive, Lamartine-i paraqitet si avokat i perandorisë së sulltanëve, themelet e së cilës kishin zënë të lëkundeshin dhe po i kanosej rreziku serioz i shkatërrimit. Mirëpo, turkofilia e poetit romantik kuptohet lehtë po qe se kemi parasysh se ai e vizitoi Turqinë dy herë: më 1833 dhe më 1850. Herën e dytë Lamartine-i shkoi në Azinë e Vogël pas disfatës që pësoi në zgjedhjet për kryetar të Republikës më 1848, me qëllim që të vendosej përgjithmonë në një pronë të madhe bujqësore, që

¹ Ymer Jaka, *Lidhjet letrare shqiptaro-frënge*, Rilindja, Prishtinë, 1979, fq. 11.

² Duke shkuar në Jerusalem, ai u ndal disa ditë në Athinë, ndërsa në të kthyer kaloi nëpër Bullgari dhe Serbi.

³ Alphonse de Lamartine, *Souvenirs, impressions, pensées et paysages, pendant un voyage en Orient (1832-1833), ou Notes d'un voyageur*, Paris, 1835.

⁴ Alphonse de Lamartine, *Le dernier chant du pèlerinage de Chalde Harold*, Paris, 1826, fq. 216-217.

⁵ Alphonse de Lamartine, *Histoire de la Turquie*, Paris, 1854-1855.

ia kish dhuruar sulltani për 30 vjet. Është e vërtetë se Lamartine-i qëndroi në Azinë e Vogël një kohë të shkurtër, mirëpo ai nuk harroi të jetë mirënjohës ndaj një vendi që ia hapi dyert me bujari.

Nuk duhet harruar se që në udhëtimin e parë në Orient Lamartine-i shprehu një simpati të posaçme, për të mos thënë një admirim, për turqit, duke mos harruar të vë në pah edhe dobësitë e perandorisë së tyre, të cilat e shpënin kah gremina.¹Pas udhëtimit të datë, ai bën thirrje Europës që t'ia mbajë anën Turqisë në luftë kundër Rusisë, mbasi sipas tij „Turqia është pararojë e lirisë në Europë”.² Vlerësimi i kësaj veprë shiqohet nga këndvështrimi i autorit në atë pjesë të veprës *Histoire de la Turquie*, që i është kushtuar Skënderbeut.

Sikundër gati të gjithë historianët e Turqisë, Lamartine-i nuk mundi ta trajtojë historinë e kësaj perandori pa folur për Skënderbeun. Mirëpo, ndryshe nga autorët tjerë, Lamartine-i trajtoi me vëmendje të posaçme Skënderbeun. Kur bën përshkrimin e heroit të Krujës, ai e përshkruan edhe Shqipërinë. Kështu, para se të mësojë për rezistencën historike të Skënderbeut kundër turqve, lexuesi mëson për atdheun e trimit dhe për cilësitë e popullit shqiptar. Sa u përket shqiptarëve, Lamartine-i thekson se ky popull njihet me emra të ndryshëm dhe se „origjina e tij është e errët sikundër edhe bjeshkët e vendit të tij”.

Pastaj ai shton se gjuha shqipe, duke ruajtur rrënjën e vet, është plot elemente të huaja, ndërsa feja e tyre thotë ai, e bastarduar nga fqinjësia, pushtimet dhe kolonizimi i fushave të tyre, luhetet prej islamizmit deri te krishterizmi, prej shizms greke deri te katolicizmi romak, sipas racave me të cilat bëjnë marrëdhënie ose luftojnë. Lamartine-i vë në pah lashtësinë e popullit shqiptar dhe paraqet disa hipoteza për origjinën e tij, si: „Bukuria e tyre, mashkullore te burrat, madhështore e ende burrërore te gratë, është në zë në Orient... Atyre u pëlqejnë armët, luftërat, aventurat, bredhjet në tokë dhe det, fushat e luftës...”. Shpirti i tyre është poetik, sikurse edhe doket e tyre: këngët e tyre popullore, sidomos ato të epokës së tyre heroike nën bashkatdhetarin e tyre, Skënderbeun.³

Përfundimi

Numri i madh i veprave të botuara në gjuhën frënge mbi Skënderbeun dhe shtrirja e tyre kohore tregojnë se sa i rëndësishëm ky personalitet historik ka gjetur një pasqyrim mjaft të gjërë në letërsinë frënge. Krijimet e para letrare mbi heroin tonë kombëtar u paraqitën në Francë bashkë me përkthimin e adaptuar të veprës së Marin Barletit nga Jacques de Lavardin. Në fillim hyri në letërsi me anë të poezive kushtuar botimit të librit të Lavardin-it, ndërsa si hero romani bëhet në shekullin XVII, në kohën kur filloi të zhvillohet edhe ky lloj letrar si në Francë ashtu edhe në vendet tjera.

Gjithashtu edhe në teatrin frëng hyri më vonë, gjegjësisht në shekullin XVIII, dhe hyrja e tij në skenë nis me një operë, libreti i të cilës ka dalë nga pena e një shkrimtari të kohës që ishte Antoine-Houdar de la Motte, vepër kjo që u shfaq me mjaft sukses. Në disa raste në të gjithë llojet letrare ku përshkruhet karakteri i Skënderbeut, na kujton heronjtë e romaneve kurtuazë frëng ngase ky burrë, të cilit nuk i trembet syri para vdekjes në fushëbetejë.

Shkrimet e autorëve frëngë për Skënderbeun janë me interes, ngase janë dëshmi e popullaritetit të kësaj figure madhore të historisë sonë në Francë gjatë katër shekujsh. Lufta e një populli të vogël si shqiptarët për mbrojtjen e lirisë së vet, e njëherësh edhe të qytetërimit europian, bëri jehonë edhe në

¹Alphonse de Lamartine, *Souvenirs, impressions, pensées et paysages, pendant un voyage en Orient (1832-1833), ou Notes d'un voyageur*, Paris, 1835, fq. 586.

²Alphonse de Lamartine, *Histoire de la Turquie*, Paris, 1854, fq. 38.

³Alphonse de Lamartine, *Histoire de la Turquie*, Paris, 1854, fq. 119.

një vend relativisht larg nga Ballkani, siç është Franca dhe kjo jehonë është dëshmi se në çdo luftë të drejtë sakrificat japin frytet e tyre.

Bibliografia

- Barleti, Marin (1967). *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, Prishtinë, 1967.
- Chevreau, Urbain (1644). *Scanderbeg*, Paris.
- D'aubigné, Agrippa (1873). *Les Tragiques*, Paris.
- Faurrès, Rogatien (1912). *Skënderbeun ose heroi shqipëtar*, Sofje.
- Jaka, Ymer (1979). *Lidhjet letrare shqiptaro-frënge*, Rilindja, Prishtinë.
- Jaka, Ymer (1990). *Skënderbeu në letërsinë frënge*, Rilindja, Prishtinë.
- Konica, Faik (1900). *Një vjershë e Ronsard-it permi shqiptarët*, Revista Albania 1.
- Lamartine, Alphonse de (1835). *Souvenirs, impressions, pensées et paysages, pendant un voyage en Orient (1832-1833), ou Notes d'un voyageur*, Paris.
- Lamartine, Alphonse de (1854). *Histoire de la Turquie*, Paris.
- Lamartine, Alphonse de (1826). *Le dernier chant du pèlerinage de Chalde Harold*, Paris.
- Lavardin, Jacques de (1576). *Historia e jetës dhe të veprave të Skënderbeut*, Paris.
- Petrovich, Georges (1881). *Scanderbeg (Georges Castriota)*, Paris.
- Velu, Veli (1998). *Shqiptarët sipas udhëpërshkruesve frëngë të shekullit XIX*, Dukagjini, Pejë.